



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 10021 Prot

Shkodër, më 20.5.2025

VENDIM

Nr. 173 datë 20/5/2025

“PËR DELEGIM KOMPETENCE”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit nr.44/2015 “Kodi Procedurave Administrative Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; ligjit Nr.10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”, të ndryshuar; ligjit nr.18/2017 “Për te drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”; ligjit nr.75/2019 “Për rininë”; Udhëzimi nr. 30/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të ndryshuar;

VENDOSA:

1. Shfuqizimin e vendimit nr.754, datë 31.12.2024 të titullarit të bashkisë Shkodër .
2. Delegimin e kompetencave të Kryetarit të bashkisë Shkodër, z.Alban Preka, me detyrë zëvendeskryetar bashkisë Shkodër;
- Për nënshkrimin e çdo shkrese që ka të bëjë me institucionet publike, personat juridik/fizik dhe individ për:
 - Drejtorinë e Përgjithshme Sociale dhe Rinisë
 - Drejtorinë e Shërbimeve Sociale
 - Drejtorinë e Ndihmës Ekonomike dhe Personave me Aftësi Ndryshe.
3. Zv/Kryetari nuk mund t’i nëndelegojë këto kompetenca zyrtarëve të tjerë.
4. Kompetencat e deleguara zv/kryetarit z.Alban Preka me vendimin nr.103 datë 13.03.2025 mbeten në fuqi.
5. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen duke filluar nga data 20.05.2025 dhe përfundojnë me datë 27.05.2025, ora 16.00.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet z.Alban Preka dhe administrata bashkisë Shkodër.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen WEB të bashkisë Shkodër.

KRYETAR

Benet BECI

